



EUROPEAN CENTRE  
FOR MINORITY  
ISSUES KOSOVO

## KOMUNIKATË PËR SHTYP

Gusht, 2019

### Fillimi i një projekti të ri

Më 1 Mars, 2019 Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë, (ECMI Kosovo) filloi zbatimin e projektit tetëmbëdhjetë (18) mujorë “Veprimet ndërkufitare në Shëndetin Riprodhues në Sektorin e Shëndetësisë” të financuar nga Bashkimi Evropian përmes Programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi-Kosovë 2014-2020.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit riprodhues të grave në komunat Pejë/Peć, Istog/Istok, Klinë/Klina, Deçan /Dečani, Gjakovë /Đakovica në Kosovë me theks të veçantë duke i targetu gratë nga grupet e cënueshme dhe të marginalizuara. Në mënyrë të veçantë, ky projekt ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të shëndetit riprodhues dhe ndërgjegjësimin e popullatës për mbrojtjen e shëndetit riprodhues.

**Rezultatet e pritura të projektit:** 1) Ngritja e kapaciteteve të qendrave shëndetësore dhe cilësisë së shërbimeve të shëndetit riprodhues; 2) Rritja e vetëdijësit të grave të grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara për rëndësinë e mbrojtjes së shëndetit riprodhues dhe kryerjes së kontrollave parandaluese; 3) Hartimi dhe zbatimi i programit për mbështetjen shtatëzënësish; 4) Rritja e vetëdijësit të rinjve për shëndetin riprodhues; 5) Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar në sektorin e shëndetit riprodhues.

Për të arritur rezultatet e lartpërmendura, do të ndërmerren veprimet e mëposhtme:

- Shpërndarja e kolposkopëve, ultratzërit, autoklavëve, shkopinjëve testues të urinës, glukometrave, hemoglobinometrave, CTGve, testeve të shtatëzënisë dhe prezervativëve.
- Organizimi i aktiviteteve sensibilizuese ku do të shpërndahet material promovues, duke përfshirë broshura për shëndetin riprodhues, poster për shëndetin riprodhues, fletore, stilolapsa, folldera, çanta, gota dhe material tjera.
- Organizimi i ligjëratave për shëndetin riprodhues për nxënësit e shkollave të mesme;
- Transmetimi i spotit televiziv mbi shëndetin riprodhues.

Të gjitha këto aktivitete do të organizohen në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Spitalet Rajonale.

Për më shumë informacion mbi punën e ECMI Kosovës dhe konkretisht për zbatimin e këtij projekti, ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit në [www.ecmikosovo.org](http://www.ecmikosovo.org), faqen në Facebook "European Centre for Minority Issues Kosovo" gjithashtu mos ngurroni të na kontaktoni përmes email-it: [info@ecmikosovo.org](mailto:info@ecmikosovo.org) ose përmes numrit të telefonit +383 (0) 38 224 473.